

VENDIM
Nr. 469, datë 30.7.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
OBJEKTIT “SISTEMIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I INFRASTRUKTURËS NË
‘BLOKUN QEMAL STAFI’, KUFIZUAR NGA RRUGËT ‘KONGRESI I
MANASTIRIT’ DHE ‘BAJRAM CURRI’, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastrukturës në ‘Blokun Qemal Stafi’, kufizuar nga rrugët ‘Kongresi i Manastirit’ dhe ‘Bajram Curri’, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqiten në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë 137 173 319 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 137 173 319 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA EMËRORE PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT "SISTEMIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I INFRASTRUKTURËS NË 'BLOKUN QEMAL STAFI' KUFIZUAR NGA RRUGËT 'KONGRESI MANASTRIT' DHE 'BAJRAM CURRI'"

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. pasurie	Sip. totale truall (m²)	Sip. truall i prekur (m²)	Çmimi truall, lek/m²	Vlera në lek	Shënime në kartelë
1	BP Zakja, Duzha, Shehi, Lika	Truall	8140	3/975	286.00	256.87	35199	9,041,567	C- Korrigjim emri
2	BP Zakja, Duzha, Shehi, Lika	Truall	8140	3/976	253.50	1.44	35199	50,687	C- Korrigjim emri
3	Kadri Zakja	Truall	8140	3/305	280.00	191.38	35199	6,736,385	C- VKKP
4	Kadri Osman Zakja	Truall	8140	3/930	715.50	300.81	35199	10,588,211	Vjen nga V.20, f. 167; C- T. Nd. pasurie; E- Ka një ndërtim pa leje
5	Agim Hamid Bekteshi	Truall	8140	3/261	159.00	33.25	35199	1,170,367	C- K. dhurimi; E- Pasuria kufizohet urdhër 1449, datë 9.5.2015
6	BP Kullakshi, Mema, Llabani, Allmuca, Kallushi	Truall	8140	3/74	1444.00	333.55	35199	11,740,626	C- Dëshmi trashëgimie; E- Ka 3 ndërtime pa leje
7	BP Stafa, Zeqiraj, Sallaku, Sulajmani, Peti	Truall	8140	3/272	122.00	122.00	35199	4,294,278	C- Urdhër korrigjimi
8	Kadri Osman Zakja	Truall	8140	3/979	143.00	31.41	35199	1,105,601	C- T. nd. pas.
9	Kadri Osman Zakja	Truall	8140	3/978	1161.00	1145.58	35199	40,323,270	C- T. nd. pas.
10	Zyhra Abdyl Kalaja	Shesh	8140	3/170	816.16	667.39	35199	23,491,461	C- VKKP
11	BP Shega, Kamberi, Kullakshi, Bakllava, Kusi, Ismaili, Ibrahim, Bicaku	Truall	8140	3/308	158.00	122.89	35199	4,325,605	C- Dëshmi trashëgimie
12	BP Karaj dhe Kruja	Truall	8140	3/283	128.00	106.05	35199	3,732,854	C- Vendim gjykate
13	BP Karaj dhe Kruja	Truall	8140	3/284	133.00	93.76	35199	3,300,258	C- Vendim gjykate
14	Kadi Zakja	Truall	8140	3/84	711.00	477.00	35199	16,789,923	C- Nd. pasurie; D- Mbi këtë pasur ngrihet ndërtesa me nr. 3/84/nd., vol. 40, f. 240; E- Ka një ndërtim pa leje
15	BP Lika, Shehi	Truall	8140	3/348	428.00	13.70	35199	482,226	L. leg. nr. 997184, datë 3.4.2017. Godinë banimi 3. Kate + papafingo + 2 godina shërbimi 1 kat. sip. k. përdhes 114.8 m². Sip. soc.-eko. 101.5 m². Sip. banimi 13.3. Sip. verandë+shkallë 10.5 m². Sip. k. parë 157.3 m². Sip. k. dytë 157.3 m². Sip. papafingo 78.3 m². Sip. obj. ndihmës 16.6 m² soc.-eko. Sip. obj. ndihmës 52.5 m² soc.-eko.; C- KSH nr. 9908 REP nr. 1950 KOL, datë 30.12.2020.; D- Rivlerësohet pasuria për ¼ pjesë takuese te Matilda Duzha, në vlerën 22'264'966 lekë në bazë të apl. nr. 40186, datë 6.11.2020. Në bazë të apl. nr. 46032, datë 30.12.2020 rivlerësohet pjesa takuese ¼ e Flutura Shehi, në shumën 19'711'692 lekë.
Vlera totale						3,897.08		137,173,319	

Shënime:

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.
2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresën e ZVRPP-së, Tiranë, nr. prot. 607/2, datë 13.2.2019, shkresën e ASHK-së, Drejtoria Tiranë Veri, nr. prot. 8542/1, datë 30.10.2020, nr. prot. 8542/3, datë 29.12.2020 dhe nr. prot. 830/1, datë 17.2.2021.